



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, Rregulloren MF – Nr. – 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 parag.1.2 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, nxjerr:

### **V E N D I M**

#### **Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projektet/programet e OJQ-ve**

##### **Neni 1**

1.Për implementimin e thirrjes publike do të zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

2.Mbështetja financiare publike e OJQ-ve, për personat me nevoja të veçanta për projekte/programme në fushat: avokuese dhe lobuese për avancimin e pozitës së tyre në shoqëri, ofrimi i shërbimeve të mbrojtjes dhe këshillimeve psiko-sociale, aktivitetet lidhur me shërbimet e rehabilitimit dhe fushave tjera të ngjashme, ofrohet nga Buxheti i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kodi ekonomik 21200, në kuadër të programit 73014.

##### **Neni 2**

Mjetet financiare shpërndahen në bazë të thirrjes publike për financimin e projekteve të OJQ-ve, sipas dokumentacionit për zbatimin e thirrjes, e cila është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

##### **Neni 3**

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes sipas pikës II të këtij vendimi përfshinë:

- 1.1. Teksti i thirrjes publike
- 1.2. Udhëzimet për aplikantët
- 1.3. Formularët e aplikimit
- 1.4. Forma për vlerësimin e cilësisë së projekteve
- 1.5. Format për raportimin e zbatimit të projektit

2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:

- 2.1. Forma e përshkrimit të programit apo projektit
- 2.2. Forma e buxhetit të programit apo projektit
- 2.3. Forma e deklarimit të mungesës së fondeve të dyfishta

- 2.4. Deklarata e Partneritetit(nëse është e aplikueshme)
  - 2.5 Forma e deklaratës së programeve/projekteve të OJQ-ve të financuara nga burimet publike
  - 2.6 Deklarata për aktivitetet e kontraktorit e përmendur në përshkrimin e aktiviteteve të projektit që janë të njohur e programin /projektin dhe pjesëmarrjen e tyre në zbatimin (nëse aplikohet)
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
    - 3.1 Forma e kontratës për financimin e programit/projektit
    - 3.2 Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin/programin
    - 3.3 Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit/projektit

#### Neni 4

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të Komunës së Podujevës <https://kk.rks-gov.net/podujeve/>

#### Neni 5

1. Në përputhje me Rregulloren për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik për OJQ-të dhe udhëzuesit për aplikantët, do të formohet Komisioni Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.
2. Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.
3. Komisioni Vlerësues punët dhe detyrat do t'i ushtrojnë në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### Neni 6


- 1.Përfituesit me projekt/programet e tyre do të njoftohen për kohën e nënshkrimit të kontratave
- 2.Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### Neni 7

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-024/01-0014795/22  
Podujevë, 01 mars 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë/ propozim nr.02-020/04-0014962/22 të datës 01.03.2022, të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisionit sipas ftesës publike nr 09-016/01-0007648/22 të datës 07.02.2022, merr:

### VENDIM

#### PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-VE NË FUSHËN E SHFAQJEVE TEATRORE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

##### Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ- për organizimin e aktiviteteve rinore/kulturore, për financimin publik të programeve/projekteve sipas Thirrjes publike në fushën e shfaqjeve teatrore publikuar më 07.02.2022, themelohet komisioni në këtë përbërje:

- |                    |   |
|--------------------|---|
| 1.Rexhep Zeka,     | kryesues, shoqëria civile.  |
| 2.Teuta Ismaili,   | anëtare, zyrtare për manifestime- Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.                  |
| 3.Xheladin Çitaku, | anëtar, zyrtar për arkivl- Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.                         |
| 4. Janina Shala,   | anëtare, zyrtare e të hyrave financiare- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.                |
| 5.Ejup Babatinca,  | anëtar, udhëheqës i sektorit të ekonomisë-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. |

z.Tahir Mehana zyrtar për rini, caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

##### Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

##### Neni 3


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit  
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit  
Arkivit

Nr. 02-020/04-0015046/22  
Podujevë, 01 mars 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, në kërkesë/ propozim nr.02-020/04-0014958/22 të datës 01.03.2022, të proceduar nga Drejtorisa e Kulturës Rinisë dhe Sportit duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisionit sipas ftesës publike nr 09-016/01-0007650/22 të datës 07.02.2022, merr:

### VENDIM

#### PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR SHQYRTIMIN E APLIKACIONEVE PËR FINANCIM PUBLIK TË OJQ-KLUBEVE SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS

##### Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-Klubeve Sportive, për financimin publik të programeve/projekteve sipas Thirrjes publike në fushën e aktiviteteve sportive publikuar më 07.02.2022, themelohet komisioni në këtë përbërje:

- |                   |   |
|-------------------|---|
| 1.Jeton Havolli,  | kryesues, shoqëria civile.  |
| 2.Halil Hyseni,   | anëtar, administrator i palestrës- Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.                 |
| 3.Gramos Latifi,  | anëtar, shoqëria civile.  |
| 4. Janina Shala,  | anëtare, zyrtare e të hyrave financiare - Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.               |
| 5.Ejup Babatinca, | anëtar, udhëheqës i sektorit të ekonomisë-Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik. |

z.Agim Idrizi, zyrtar për rini caktohet anëtar rezervë, i cili zëvendëson anëtarin e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

##### Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit  
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit  
Arkivit

Nr.prot 02-020/04-0015044/22  
Podujevë, 01 mars 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja i), 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, neni 25 i Ligjit Për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit nr.03/L-164, nenet 16, 19 paragrafi 1.12) dhe 61 paragrafi 1.7) të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

### VENDIM

#### Neni 1

**znj.Arbresha Bashota**, Zyrtare për Shërbime Sociale 2, në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale caktohet zyrtare përgjegjëse për plotësimin e aplikacionit për regjistrimin dhe administrimin e kërkesave për banim social.

#### Neni 2

Zyrtarja përgjegjëse ka për detyrë që të bëj regjistrimin në platformën elektronike “Baza e të dhënave për regjistrim, monitorim dhe raportim për përfituesit ekzistues, përfituesit potencial dhe kërkesave për banim social” konform nenit 25 të ligjit nr.03/L-164 për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit.

#### Neni 3

Për punët dhe detyrat e saj zyrtarja përgjegjëse do t’i raportoj Kryetarit të Komunës.


#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I dërgohet:*  
*Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale*  
*Të caktuarës*  
*Zyrës së Personelit*  
*Arkivit*

Nr. prot. 02-020/05-0015020/22  
Podujevë, 01 mars 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr.04/-L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim, Ligjin nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**Kujtim Zhitia**, zyrtar për emergjenca në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit autorizohet në cilësinë e koordinatorit për koordinimin e aktiviteteve të gatishmërisë dhe reagimin emergjent të njësisë të zjarrfikjes dhe shërbimeve tjera emergjente në kuadër të Komunës së Podujevës.

#### Neni 2

I përmenduri, në cilësinë e Koordinatorit detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit nr.04/-L-049 për Zjarrfikje dhe Shpëtim dhe Ligjit nr. 04/-L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera si dhe aktet tjera nënligjore përkatëse.

#### Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

*Me këtë vendim njoftohen:*

*I Autorizuar*

*DSHPMSH dhe Zyra e Personelit*

*Arkiva*

**Nr.prot.02-020/05-0015012/22**  
**Podujevë, 01 mars 2022**

**Kryetari i Komunës**  
**Shqipim Bulliqi**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja (b) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neni 81 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës nr.04/L-042 dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (61.4 dhe 61.15), në bashkëpunim me zyrtarin përgjegjës të Prokurimit, Kryetari i Komunës, nxjerr:

### **V E N D I M** **PËR NDRYSHIMN E VENDIMIT PËR MENAXHIMIN E KONTRATËS SË** **PROKURIMIT**

#### **Neni 1**

Ndryshohet Vendimi për menaxhimin e kontratës së prokurimit “Hartimi i projekteve”, me nr. 61521156221 dhe nr. brendshëm i prokurimit 61521002221, dhe atë në vend të znj.Doruntina Sollova, mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës së cekur caktohet:

**z. Veton Aliu, Ing. i ndërtimtarisë-drejtimi arkitekturë**

#### **Neni 2**

Zëvendësimi bëhet për arsye se të përmendurës për nevoja të ngritjes së nivelit profesional, i është lejuar pushimi pa pagesë në kohëzgjatje prej një viti.

#### **Neni 3**


Mbikëqyrësi i menaxherit të kontratës detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me dispozitat e Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik dhe dispozitat përkatëse nënligjore.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:*  
*I caktuari*  
*Zyra e Prokurimit*

**Nr.02-020/05-0015175/22**  
**Podujeve, 02 mars 2022**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11 paragrafi 6 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Statutit të Teatrit të qytetit “Avdush Hasani” – Podujevë nr.prot.01-640-93374 të datës 28.12.2016, dhe nenin 2 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës “Avdush Hasani” nr.prot.01-640/01-0051835/21 të datës 28.06.2021, merr;

### VENDIM

#### PËR SHKARIKIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT PUBLIK TË QYTETIT “AVDUSH HASANI” NË PODUJEVË

##### Neni 1

Shkarkohet Këshilli Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit “Avdush Hasani” në Podujevë, i emëruar me vendimin nr.prot.02-020/04-0003749/21 të datës 15 janar 2021.

##### Neni 2

Shkarkimi i Këshillit sipas nenit 1 të këtij vendimi, bëhet për shkak të mos efikasitetit dhe mos kryerjes së punëve dhe detyrave të përcaktuara me rregullativën ligjore përkatëse në fuqi.

##### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Me këtë vendim njoftohen:  
Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS  
Ish anëtarët e Këshillit (përmes DKRS)  
Teatri i Qytetit  
Arkivi*

**Nr.02-020/02-0016044/22  
Podujevë, 04 mars 2022**







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 04/L-175 për Inspektoratin e Mjedisit Ujërave Natyrës Planifikimit Hapësinorë dhe Ndërtimit, nenin 53.1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.7, të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

### VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

#### Neni 1

Ngritet Komisioni për shqyrtimin e ankesave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, ujërave dhe natyrës si dhe në fushën e ndërtimit dhe planifikimit hapësinor në Komunën e Podujevës, në këtë përbërje:

1. **Rizah Muçolli**, Zyrtar për Mbrojtje të Mjedisit- Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, kryesues
2. **Ismet Kadriu**, Inxhinier-Drejtorja e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar
3. **Ejup Babatinca**, Udhëheqës i Sektorit të Ekonomisë-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtar

#### Neni 2

Komisioni ka për obligim shqyrtimin e të gjitha ankesave ndaj vendimeve të Drejtorive të Komunës që kanë të bëjnë por pa u kufizuar me lejet komunale mjedisore, lejet ujore, të mbrojtjes së natyrës dhe lejet ndërtimore.

#### Neni 3

Mandati i Komisionit është në kohëzgjatje të pa caktuar, përkatësisht deri në marrjen e një vendimi tjetër.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, ndërsa shfuqizohet vendimi nr.02-020/04-0047079/21 i datës 11 qershor 2021.

Vendimi u dërgohet:  
Anëtarëve të Komisionit  
Drejtorisë së Inspeksionit  
Arkivit

Nr.02-020/04-0016448/22  
Podujevë, 04 mars 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 11 dhe 58 shkronja g) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, nenin 30 të Rregullores (QRK) NR. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe nenet 13 dhe 61 paragrafi 1.7 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862, nxjerr;

### VENDIM PËR NGRITJEN E GRUPIT PUNUES

#### Neni 1

Për hartimin dhe përgatitjen e aktit të brendshëm të organizimit dhe klasifikimit të vendeve të punës në Administratën e Komunës së Podujevës, ngritet Grupi punues në këtë përbërje:

- |   |           |
|---|-----------|
| 1. Marigona Lahu, <i>Nënkryetare e Komunës,</i>                                       | Kryesuese |
| 2. Antoneta Ejupi, <i>Drejtorja e Administratës, U.D. Drejtoreshë,</i>                | anëtare   |
| 3. Avni Fetahu, <i>Drejtorja e Arsimit - UD drejtor,</i>                              | anëtar    |
| 4. Driton Veliu, <i>Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - UD drejtor,</i> | anëtar    |
| 5. Fatlum Osmani, <i>Drejtorja e Buxhetit dhe Financave - UD drejtor,</i>             | anëtar    |
| 6. Mujë Munolli, <i>Shefi i Kabinetit në Zyrën e Kryetarit,</i>                       | anëtar    |
| 7. Sabedin Namani, <i>Zyra ligjore</i>  | anëtar    |
| 8. Fitim Bunjaku, <i>Zyra e Personelit</i>  | anëtar    |

#### Neni 2

Grupi punues harton dhe përgatitë aktin e brendshëm si dhe Organogramin në përputhje me Ligjin për Zyrtarët publik, Rregulloren për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Grupi punues mund të bashkëpunojë dhe koordinojë me Departamentin përkatës të Nivelit qendror për sqarime dhe udhëzime shtesë varësisht nevojave të paraqitura gjatë procesit të hartimit të aktit.

#### Neni 3

Për punën e kryer Grupi punues informon Zyrën e Kryetar në formë të shkruar.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0017772/22  
Podujevë, 09 mars 2022

Kryetari i Komunës  
Shefqij Bunjaku





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, neni 19 paragrafi 2.3 të Ligjit nr.04/L-045 Për Partneritet Publiko Privat, neni 13 paragrafi 1 i Direktivës nr.1/2011 Mbi Procedurat për Shqyrtimin dhe Aprovimin e Projekteve PPP, neni 16, të Statutit të Komunës nr.prot.01-020/01-0050862/18, merr:

### VENDIM

#### Neni 1

Themelohet njësia për implementimin e projektit – NJIP për ndërtimin e parkingut nëntokësor në Komunën e Podujevës.

#### Neni 2

Njësia e themeluar sipas nenit 1 të këtij vendimi ka këtë përbërje;

Ismet Kadriu, kryesues - *Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit.*

Florie Mani, anëtare - *Drejtoria e Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit.*

Ejup Babatinca, anëtar - *Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik.*

Janina Shala, anëtare - *Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.*

Granit Hasani, anëtar - *Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim.*

Osman Bajrami, anëtar - *Zyra Ligjore.*

#### Neni 3

Themelim i NJIP bëhet me qëllim dhe në funksion të implementimit të projektit për ndërtimin e parkingut nëntokësor në Komunën e Podujevës, projekt i cili do të realizohet në përputhje me legjisllacionin në fuqi për partneritetit publiko privat.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*I dërgohet:*


*Anëtarëve*

*Drejtorive përkatëse*

*Arkivit*

**Nr. prot. 02-020/04-19601/22**  
**Podujevë, 16 mars 2022**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpetimz Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 11 paragrafi 6 të Ligjit për Teatrot nr. 04/L-106, nenit 12 paragrafi 1.1 të Rregullores nr.04/2015 për kushtet dhe kriteret e themelimit të teatrove kombëtare dhe të teatrove të qyteteve (MKRS), nenit 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me nenin 12 paragrafi 2 të Statutit të Teatrit të qytetit "Avdush Hasani"- Podujevë nr.prot.01-640-93374 të datës 28.12.2016, dhe nenin 2 paragrafi 4 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Teatrit të Qytetit të Podujevës "Avdush Hasani" nr.prot.01-640/01-0051835/21 të datës 28.06.202, merr;

### VENDIM PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT DREJTUES TË TEATRIT PUBLIK TË QYTETIT "AVDUSH HASANI" NË PODUJEVË

#### Neni 1

Emërohet Këshilli Drejtues i Teatrit Publik të Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, me mandat katër (4) vjeçar, në përbërje:

1. **Doruntina Hasani,** *dizajnere grafike*
2. **Mehmet Breznica,** *aktor*
3. **Saranda Stublla,** *juriste*
4. **Arta Sadiku,** *profesoreshë e artit muzikor*
5. **Xheladin Çitaku,** *profesor i degës së letërsisë*

Kryetari/ja i Këshillit Drejtues zgjedhet konform Statutit të Teatrit dhe Rregullores së punës së Këshillit Drejtues.

#### Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë dhe aktivitetet, Këshilli Drejtues, i ushtron në pajtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndërsa për punën e kryer kompensohet sipas legjislacionit në fuqi.

#### Neni 3


Kryetarit të Komunës, Këshilli Drejtues i Teatrit i paraqet raport të punës së paku një (1) herë në vit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:  
Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS  
Anëtarëve të Këshillit (përmes DKRS)  
Teatrit të Qytetit  
Arkivi*

**Nr.02-020/04-0020237/22  
Podujevë, 18 mars 2022**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 61.1 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-50862/18, Kryetari i Komunës së Podujevës, jep;


### A U T O R I Z I M


Autorizohet z.Faik Rama, nr. personal i letërnjoftimit [redacted], nr. i kartelës identifikuese zyrtare KPO 0071, përfaqësues i Komunës për konteste juridike, të përfaqësojë Komunën e Podujevës në procedura gjyqësore në të gjitha gjykatat, në të gjitha lëndët, përkatësisht çështjet juridike në të cilat Komuna është në cilësinë e paditëses ose të paditurës dhe lidhur me këtë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike.

Autorizimi vlen deri më 31.12. 2022.

Nr.02-020/05-0020008/22  
Podujevë, 18 mars 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0014604 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 28 shkurt 2022, merr,

### VENDIM

#### PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE STACIONI I AUTOBUSËVE PODUJEVË

##### Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, emërohet,

**Vigan Salihu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik**

##### Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

##### Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-020/04-0014604/22 të datës 28 shkurt 2022.

##### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;  
Të emëruarit  
Anëtarëve të Komisionit  
Arkives*

**Nr.02-020/02-0020257/22  
Podujevë, 18 mars 2022**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja l) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 nr.20) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.12 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0014612/22 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 28 shkurt 2022, merr,

### VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH.A. PODUJEVË

#### Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. – Podujevë, emërohet,

**Pajtim Balaj, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit**

#### Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

#### Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.prot.01-020/04-0014612/22 të datës 28 shkurt 2022,


#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;  
Të emëruarit  
Anëtarëve të Komisionit  
Arkives*

**Nr.02-020/02-0020247/22  
Podujevë, 18 mars 2022**

**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 37 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. 06/-082 dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**Ahmet Ahmeti**, zyrtar i lartë për koordinimin e të drejtave të njeriut në Zyrën e Kryetarit të Komunës, krahas punëve dhe detyrave nga pozita sipas akt-emërimit, caktohet edhe në cilësinë e zyrtarit për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të Komunës së Podujevës.

#### Neni 2

I përmenduri, sipas këtij vendimi angazhohet në kryerjen e punëve dhe aktivitetet e përcaktuara sipas Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në fuqi.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në një akt tjetër administrativ.

*Me këtë vendim njoftohen:*

*I caktuari*

*Drejtoritë e Komunës dhe shërbimet tjera në kuadër të Komunës*

*Arkiva*

Nr.prot.02-020/05-0020494/22  
Podujevë, 21 mars 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Balliqi







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 58 shkronja f) dhe 62.2 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 61 parag. 1.6 dhe 64 parag.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, të datës 29 qershor 2018, sipas kërkesës nr. 02-104/02-0020502/22, datë 21.03.2022, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M PËR LIRIM NGA DETYRA E U.D. DREJTORESHËS SË DREJTORISË SË PRONËS KADASTRIT DHE GJEODEZISË

#### Neni 1

znj. **Bahrije Shatrolli - Mehmeti**, lirohet nga detyra e U.D. Drejtoreshës së Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

#### Neni 2

E përmendura lirohet në kërkesë të saj, për arsye personale dhe profesionale.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi më datë 31.03.2022.

*I dërgohet:*  
*Të përmendurës*  
*Zyrës së Personelit*  
*Arkivit*


Nr.02-020/02-0020666/22  
Podujevë, 21 mars 2022

Kryetari i Komunës  
*Shpejtim Buhiqi*





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 8 dhe 13, të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere dhe në kërkesë nr.prot 06-400/04-0020531/22, të datës 21.03.2022, Kryetari i Komunës, merr:

### VE N D I M PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE

#### Neni 1

z.Ramadan Sadiku nga fshati Dumnice e Poshtme, Komuna e Podujevës, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore si dhe pamundësisë për mbulimin e shpenzimeve mjekësore dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

#### Neni 3


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.


#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0020834/22  
Podujevë, 22 mars 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 8 të Rregullores MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenin 16 të Statutit të Komunës së Podujevës nr. 01-020/01-0050862/18, duke përfshirë dy përfaqësues të shoqërisë civile, në cilësinë e anëtarëve të këtij komisioni, të zgjedhur nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përmes Thirrjeve publike të dt. 04.03.2022 dhe 18.03.2022, nxjerr:

### V E N D I M

#### Neni 1

Për shqyrtimin e aplikacioneve të OJQ-ve për mbështetje financiare për projekt/programet që kontribuojnë në zbatimin e programit të DSHMS-së, i cili u dedikohet personave me nevoja të veçanta sipas Thirrjes publike të publikuar më 02.03.2022, themelohet komisioni në përbërje:

1. **Makfirete Zeka**, kryesuese, zyrtare për kujdesjen e personave me aftësi të kufizuar- Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
2. **Sheribane Çitaku**, anëtare, zyrtare për çështje pedagogjike - Drejtoria e Arsimit
3. **Haxhere Ajvazi** anëtare, shefe e thesarit- Drejtoria e Buxhetit dhe Financave
4. **Arsim Rashiti**, anëtar- Shoqëria civile
5. **Valdet Plakolli**, anëtar-Shoqëria civile

**Naxhie Hasani**, zyrtare për invalid të luftës dhe familjeve të dëshmorëve-Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, caktohet anëtare rezervë, e cila zëvendëson anëtarin/en e Komisionit në rast të paraqitjes së konfliktit të interesit gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të aplikacioneve.

#### Neni 2

Komisioni, detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të Komisionit  
Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale  
Arkivit

Nr. 02-020/04-0020961/22  
Podujevë, 22 mars 2022





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (*Lista 2 Ndërmarrjet Publike Lokale nr.11 Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.a*) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr. 01-020/04-0014598/22 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 28 shkurt 2022, merr këtë,

### **VENDIM**

#### **PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE – KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SH.A.**

##### **Neni 1**

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike - Kompania Regjionale e Mbeturinave "Pastrimi" sh.a, emërohet,

*z.Bahri Selimi, U.D. drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit*

##### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

##### **Neni 3**

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr.01-020/04-0014598/22 të datës 28 shkurt 2022.


##### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;  
Të emëruarit  
Anëtarëve të Komisionit  
Arkives*

**Nr.02-020/04-0021467/22**  
**Podujevë, 23 mars 2022**

**Kryetari i Komunës**  
**Shpejtim Balliqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 17 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

### VENDIM

### PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR RISHQYRTIMIN E DRAFT PLANIT TË MOBILITETIT TË QËNDRUESHËM URBAN (PQMU)

#### Neni 1

Ngritet Komisioni për rishqyrtimin e draftit të Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PQMU) në qytetin e Podujevës, në përbërje:

**Besar Hakiqi**- Drejtorja e Inspeksionit, kryesues

**Afrim Mulliqi**-Drejtorja e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, anëtar

**Memli Gashi**-Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik, anëtar

**Avni Maloku**-Drejtorja e Arsimit, anëtar

**Musli Kutleshi**-Drejtorja e planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, anëtar

#### Neni 2

Komisioni ka për detyrë të rishqyrtoj draftin e Planin Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PQMU), të vlerësojë harmonizimin e të njëjtit me dokumentet e planifikimit hapësinorë dhe aktet tjera përkatëse që i referohen fushës që trajtohen në planin e cekur, si dhe të bëjë identifikimin e ndryshimeve të nevojshme që duhet përfshihen në draftin e Planit të Mobilitetit.

#### Neni 3

Komisioni, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit për punën e tij informon Kryetarin e Komunës në formë të shkruar.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:*

*Anëtarëve të Komisionit*

*Arkivit*

Nr. 02-020/04-0021941/22  
Podujevë, 24 mars 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja g) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nr. nenet 16 dhe 61 parag.1.7 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, nxjerr këtë:

### URDHËRESË

#### I

Urdhërohen Drejtorët e Drejtorive, si dhe përgjegjësit e njësive dhe institucioneve vartëse në kuadër të Komunës së Podujevës të angazhohen maksimalisht në respektimin e dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me theks sa i përket procedurave të publikimit dhe shpalljeve të dokumenteve dhe akteve të ndryshme komunale që ndërlidhen me të dhënat personale të individëve dhe subjekteve tjera të përcaktuara sipas Ligjit në fjalë.

#### II

Për të gjitha rastet e përpunimit të të dhënave personale nga ana e zyrtarëve përkatës, paraprakisht duhet të komunikohet me zyrtarin komunal të caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale, nga i cili do të merren instruksionet dhe konfirmimet lidhur me përpunimin e të dhënave.

#### III

Gjithashtu në rast se aktualisht ka publikime të të dhënave personale që bien ndesh me dispozitat ligjore në fuqi, brenda afatit sa më të shkurtër të tërhiqen dhe të njëjtat të përpunohen në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale në fuqi.

#### IV

Urdhëresa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Iu dërgohet:  
Drejtorëve të Drejtorive  
Përgjegjësve të njësive dhe institucioneve vartëse të Komunës  
Zyrtarit të caktuar për mbrojtjen e të dhënave personale  
Për njoftim; zyrtarëve përmes Drejtorëve të Drejtorive përkatëse  
Arkivit*

**Nr. 02-016/01-0021874/22  
Podujevë, 24 mars 2022**

**Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulfiqi**





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenet 14 dhe 61 paragraf 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës së Drejtorit të Drejtorisë së Inspeksionit nr. prot. 02-112/02-0022016/22, datë 25.03.2022 Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**AUTORIZOHET z. Ahmet Ahmeti**, zyrtar i lartë për koordinimin e të drejtave të njeriut në Zyrën e Kryetarit të Komunës, për kryerjen e punëve dhe detyrave si dhe të nënshkruaj dokumentacionin nga kompetencat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit të Sektorit për inspektime në Drejtorinë e Inspeksionit-DI.

#### Neni 2

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Inspeksionit dhe Zyra e Personelit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit, dhe vlen deri në emërimin e udhëheqësit të sektorit sipas procedurave ligjore, apo deri në një akt tjetër administrativ.

#### Neni 4

I përmenduri deponon nënshkrimin për vulosjen e dokumentacionit nga fushë veprimtaria e pozitës së udhëheqësit të Sektorit për inspektime në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit.

Nënshkrimi i të autorizuarit \_\_\_\_\_

Me këtë vendim njoftohen:  
I Autorizuari  
DI dhe Zyra e Personelit  
Arkiva

Nr.prot.02-020/05-0022042/22  
Podujevë, 25 mars 2022





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 8 dhe 13, të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0002354 të datës 12 janar 2021, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere dhe në kërkesë nr.prot 06-400/04-0021781/22, të datës 24.03.2022, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE

#### Neni 1

z.Daut Avdiu nga fshati Brainë Komuna e Podujevës, me vendbanim në Podujevë, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike dhe shëndetësore dhe në pamundësi të mbulimit të shpenzimeve dhe trajtimit të mëtutjeshëm mjekësor i jepet ndihmë financiare në shumë 500.00€.

#### Neni 2

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe të njëjtat bartet përmes bankës në llogarinë e të përmendurit.

#### Neni 3

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### Neni 4


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-400/03-0022072/22  
Podujevë, 25 mars 2022

Kryetari i Komunës  
Shpejtim Bulliqi







Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronjat g) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, dhe nenet 14 dhe 61 parag 1.7 të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18, Kryetari i Komunës, merr:

### V E N D I M

#### Neni 1

**Autorizohet Kujtim Zhitia**, zyrtar për emergjenca në Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit për kryerjen e punëve dhe detyrave nga pozita e zyrtarit për komunikacion dhe transport në kuadër të Drejtorisë së cekur.

#### Neni 2

Autorizimi sipas nenit 1 jepet për shkak të pamundësisë së mbulimit të punëve dhe detyrave nga pozita e cekur, për arsye se zyrtari për komunikacion dhe transport aktualisht është në pushim vjetor dhe i njëjti pensionohet nga data 02.05.2022.

#### Neni 3

Për zbatimin e vendimit kujdeset Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe vlen deri në rekrutimin e zyrtarit për komunikacion dhe transport sipas procedurave ligjore në fuqi, apo deri në marrjen e një akti tjetër administrativ.

*Me këtë vendim njoftohen:  
I Autorizuari  
DSHPMSH dhe Zyra e Personelit  
Arkiva*

**Nr.prot.02-020/05-0023855/22  
Podujevë, 31 mars 2022**

